



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në pajtim me dispozitat e nenit 16, pika 16.1, shkronjat h,k – përgjegjësitë dhe pushteti i Komunës, dhe të dispozitave të nenit 32, pika 32.1, shkronja e – përgjegjësitë e Kuvendit, të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 – 445, të dt. 16.4.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 11.9.2008, miratoi

V E N D I M I N
P Ë R
NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR
DHËNIEN E BANESAVE NË SHFRYTËZIM ME QIRA

I. DISPOZITAT HYRËSE

NENI 1

Miratohet Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dhënie e banesave në shfrytëzim me qira 01 nr. 215 -361, të dt. 4.5.2006.

NENI 2

Me këtë Vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave të rregullores së cekur në nenin 1, në pajtim me Ligjin për vetëqeverisjen lokale, Ligji nr. 03/L – 40 dhe të Statutit të Komunës të miratuar me 31.3.2008.

II. NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET

NENI 3

Neni 6, shkronja **a** ndryshohet dhe në të thuhet:

“Për të punësuarit në Shërbimin civil të Komunës bëhet nga Komisioni për çështje banesore”.

NENI 4

Neni 7 ndryshohet dhe në të thuhet:

“Kontratën mbi shfrytëzimin e banesës, në mes të shfrytëzuesit të banesës dhe pronarit të banesës, Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e lidh Kryetari i Komunës”.

NENI 5

Neni 8 ndryshohet dhe në të thuhet:

“Për implementimin e mënyrës së shfrytëzimit të banesës do të kujdeset Drejtoria e Pronës dhe Kryetari i Komunës”.

NENI 6

Në nenin 12

a) shkronja **b** - Posti, duhet të jetë:

b) Posti:

- Kryetari i Komunës.....	150 pikë,
- zv.kryetari.....	140 pikë,
- shefat e grupeve parlamentare.....	110 pikë,
- këshilltarët komunal.....	110 pikë,
- drejtorët e drejtorive.....	110 pikë,
- drejtorët e institucioneve kom., shefi i sektorit – shefi i zyrës.....	100 pikë,
- udhëheqësi – koordinatori i shërbimit	80 pikë,
- bashkëpunëtori profesional – inspektori.....	80 pikë,
- bashkëpunëtori - asistenti administrativ.....	70 pikë,
- të tjerët.....	60 pikë.

b) shkronja **c** - Kontributi në punë, duhet të jetë:

c) Kontributi në punë

Kontributi në punë varet nga pesha dhe ndërlikueshmëria e punës, angazhimi dhe arritja e rezultateve në kryerjen e punëve. Të punësuarit i takojnë 10 - 35 pikë.

Vlerësimin për kontributin e të punësuarit në Shërbimin civil e bën Kryetari i Komunës përmes drejtorit të drejtorisë apo institucionit.

Vlerësimin për kontributin e këshilltarëve të Kuvendit e bën Kryetari i Komunës përmes Kuvendit të Komunës.

NENI 7

Neni 14, pika 14.1 ndryshohet dhe në të thuhet:

“Për përgatitjen e propozimit për zgjidhjen e çështjeve banesore të të punësuarve në Shërbimin civil, Kryetari i Komunës formon Komisionin për çështje banesore, ndërsa Komisionin për këshilltarë të Kuvendit e emëron Kuvendi i Komunës”.

Neni 8

Në nenin 15

a) Pika 15.4 ndryshohet dhe në të thuhet:

“Komisioni për çështje të banimit të shërbyesve civilë merr vendim për ndarjen e banesave, ndërsa Komisioni për çështje banimi të këshilltarëve dhe grupeve tjera, listën përfundimtare për dhënien e banesës në shfrytëzim me qira ia dërgon Kuvendit për miratim”.

b) Pika 15.5 ndryshohet dhe në të thuhet:

“Ndaj Vendimit të Komisionit për çështje të banimit të shërbyesve civilë mund të ushtrohet ankesë komisionit të ankesave”.

c) Pika 15.6 ndryshohet dhe në të thuhet:

“Ndaj Vendimit të Kuvendit për ndarjen e banesave këshilltarëve dhe grupeve tjera, parashtrohet padi pranë Gjykatës Supreme të Kosovës.

NENI 9

Neni 20 shlyhet.

NENI 10

Në nenin 21 duhet të jetë:

“Në bazë të vendimit të Komisionit për çështje banesore, kandidatit i jepet vendimi për ndarjen e banesës. Vendimin për dhënien e banesës në shfrytëzim me qira shërbyesit civil e nënshkruan kryetari i Komisionit për çështje banesore, kurse për kategoritë tjera Kryetari i Komunës”.

NENI 11

Ne nenin 22, pika 22.1 ndryshohen dhe në te thuhet:

“Kandidatit – shërbyesit civil të cilit nuk i është miratuar kërkesa, ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh pas pranimit të Vendimit. Ankesa i parashtrohet Komisionit për ankese të Komunës”.

Ne nenin 22, pika 22.3 ndryshon dhe në te thuhet:

“Komisioni i ankesave, në afat prej 30 ditësh do të marrë Vendim për ankesat e paraqitura. Vendimi i marrë është përfundimtar”.

NENI 12

Neni 25, pika 25.2 ndryshohet dhe në të thuhet:

“Zgjedhja e kryetarit të ri dhe e Kuvendit të ri, nuk mund të jetë shkak për rishqyrtimin e procedurës për dhënien e banesës në shfrytëzim”.

III.DISPOZITAT KALIMTARE

NENI 13

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga ana e Kuvendit të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 361-1327, më 11.9.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof. Dr. Isa Mustfa